




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica - Mitrovica Municipality




DREJTORIA E MBROJTJES SË MJEDISIT DHE PYJEVE



PLANI DHE PROGRAMI I PUNËS PËR VITIN 2025

KOMUNA E MITROVICËS
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit



Mitrovicë
Dhjetor-2024

I PUNËS SË DREJTORISË PËR MBROJTJEN E MJEDISIT DHE PYJEVE PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2025



Plani i punës së Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Pyjeve për periudhën janar-dhjetor 2025 ka për qëllim prezantimin e aktiviteteve dhe sfidave mjedisore me të cilat përballet kjo Drejtori. Bazuar në rreziqet mjedisore dhe ndikimin e tyre në cilësinë e jetesës, do të paraqiten materialet dhe aktivitetet përkatëse. Trajtimi i këtyre çështjeve do të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, pa ndonjë rend të paracaktuar, por duke u siguruar që çdo aspekt të jetë pjesë integrale e planit të punës.

Objektivat kryesore të Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Pyjeve

- **Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në komunë**, duke përfshirë inkasimin e borxheve, zgjerimin e shërbimeve dhe trajtimin e kërkesave për Leje Mjedisore Komunale.
- **Monitorimi i vazhdueshëm i pyjeve** për të parandaluar prerjet ilegale dhe dëmtimet, në bashkëpunim me Policinë dhe sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës.
- **Vëzhgimi i gjendjes mjedisore**, përfshirë cilësinë e ajrit, ujit, ndotjen e tokës dhe biodiversitetin.

Egzon Sadiku

Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Pyjeve

PLANI I PUNËS SË DREJTORISË PËR MBROJTJEN E MJEDISIT PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025

Objektivat Kryesore

- Monitorimi i situatës mjedisore dhe zbatimi i masave për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes.
- Zhvillimi i programeve edukative dhe fushatave për vetëdijesimin e qytetarëve mbi mbrojtjen e mjedisit, në bashkëpunim me institucionet arsimore, organizatat qeveritare dhe joqeveritare, iniciativat lokale dhe mediat.
- Rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe implementimi i sistemeve të reja për ujitje me ujë industrial për të reduktuar ndotjen nga metalet e rënda.
- Monitorimi i ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës, publikimi i rezultateve dhe bashkëpunimi me OBSH-në (WHO) dhe Ministrinë e Mjedisit për vendosjen e pajisjeve të monitorimit.
- Zbatimi i strategjive dhe planeve operacionale për menaxhimin e mbeturinave dhe rivitalizimin e hapësirave urbane dhe rurale.

Aktivitetet Kryesore të Drejtorisë

1. Menaxhimi i Mbeturinave dhe Gjelbërimi

- Inkasimi i taksës për mbeturina dhe monitorimi i shërbimeve të pastrimit.
- Rivitalizimi dhe gjelbërimi i zonave urbane dhe rurale, duke përfshirë pastrimin e hapësirave publike.
- Implementimi i programit për ndarjen në burim dhe riciklimin e mbeturinave.
- Plani operativ për trajtimin e mbeturinave vëllimore dhe zbatimi i rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave.

2. Mbrojtja nga Ndotja dhe Monitorimi Mjedisor

- Monitorimi dhe analiza e cilësisë së ajrit, ujit dhe ndotjes së tokës.
- Marrja e mostrave të dheut në zonat e ndotura për vlerësimin e rrezikut.
- Mbrojtja e popullatës nga ndotja me metale të rënda përmes shtimit të sipërfaqeve të gjelbëruara dhe përdorimit të teknikave të reja të ujitjes.

3. Fushatat për Vetëdijesimin Publik

- Fushata për ndërgjegjësimin e popullatës mbi ndikimet e ndotjes mjedisore dhe mënyrat për reduktimin e saj.
- Organizimi i aktiviteteve sensibilizuese si pjesë e Ditës Botërore të Mjedisit (5 Qershori) dhe Ditës së Tokës (22 Prilli).

- Implementimi i fushatës "Mbroni fëmijët tuaj nga helmimi me plumb" përmes aktiviteteve remediale si gjelbërimi, largimi i dheut të kontaminuar dhe sjellja e dheut të freskët.

4. Zhvillimi i Politikave dhe Strategjive Mjedisore

- Harmonizimi i legjislacionit mjedisor me standardet e BE-së dhe përmirësimi i kornizës ligjore për mbrojtjen e mjedisit.
- Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

5. Përmirësimi i Infrastrukturës Mjedisore

- Vendosja e bokseve për mbeturina, karrigeve dhe elementeve të tjera urbane në parqe dhe zona të frekuentuara publike.
- Implementimi i projekteve për rikultivimin e zonave të dëmtuara mjedisore.

Ky plan synon të përmirësojë cilësinë e jetesës dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit urban dhe rural.

PLANI I PUNËS SIPAS MUAJVE

OBJEKTIVAT		DETYRAT	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS	
				PARËSOR	DYTËSOR
Janar	Zbatimi i objektivave te PKMM- Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave	Zbatimi sipas masave dhe procedurave të parapara,	Miratimi i planit	DMMP/ Kuvendi	Komuniteti
	Monitorimi i sistemit të mbeturinave, Giz, Komunë, MMPHI	Zbatimi sipas procedurave të parapara.	Raportimi në AMMK dhe GIZ	DMMP	
	Hartimi dhe Publikimi i Raportit Vjetor për MMPH-në për Mbeturina 2025	Zbatimi sipas procedurave të parapara.	Hartimi i raportit vjetor	DMMP	KRM“UNIT ETI”sh.a.
	Zbatimi i Ligjit VNM dhe UA për LMK (vlerësimi i ndikimit në mjedis)	Zbatimi sipas procedurave të parapara.	Harmonizomi me rregullore komunale	DMMP	Ministria
	Aktivite për ngritjen e vetëdijes në komunitet rreth ngrohjes globale dhe mjedis	Propozimi sipas procedurave të parapara.	Përzgjedhja e projektit të dala nga DMMP	DMMP	Universiteti i Mitrovicës.
	Monitorimi i zonave te mbrojtura të përcaktuara në PLVM	Procedimi sipas procedurave të parapara.	Hartimi i planit	DMMP	Ministria, Komuniteti
	Monitorimi i deponisë së mbeturinave në Gërmovë	Monitorimi i gjendjes së deponisë së mbeturinave	Vizita në teren dhe vlerësimi i gjendjes	DMMP	KRM“UNIT ETI”sh.a.
	Monitorimi i lokacioneve për gjueti	Monitorimi i gjendjes së vengjuetise	Shoqata „Trepqa “ e perzgjedhur sipas proceduarve te parapara ligjore	DMMP	Ministria
	Monitorimi i mbeturinave te deponisë siç është mbulimi i rregulltë	Propozimi sipas procedurave të parapara.	Pranimi i Raporteve me shkrim nga kompania e angazhuar per ecurine e punve	DMMP	Kuvendi Komunal
	Organizimi i një tryeze për Mjedis	Propozimi sipas procedurave të parapara	Organzimi në bashkëpunim me palet e interesit	DMMP	UMIB OJQ-të Palet e Interesit

Mars	Monitorimi i mbeturinave te deponisë siç është mbulimi i rregulltë	Propozimi sipas procedurave të parapara.	Pranimi i Raporteve me shkrim nga kompania e angazhuar per ecurine e punve	DMMP	Kuvendi Komunal
	Zbatimi i Ligjit VNM dhe UA për LMK (vlerësimi i ndikimit në mjedis)	Zbatimi sipas procedurave të parapara.	Harmonizomi me rregullore komunale	DMMP	Ministria
	Aktivitetet për ngritjen e vetëdijes në komunitet rreth ngrohjes globale dhe mjedis	Propozimi sipas procedurave të parapara.	Përzgjedhja e projektit të dala nga DMMP	DMMP	Universiteti i Mitrovicës.
	Monitorimi i menaxhimit të mbeturinave në Gërmovë	Monitorimi i gjendjes së deponisë së mbeturinave	Vizita në teren dhe vlerësimi i gjendjes	DMMP	NP“UNITE TI”
	Monitorimi i lokacioneve për gjueti	Monitorimi i gjendjes së vengjuetise	Shoqata „Trepqa“ e perzgjedhur sipas proceduarve te parapara ligjore	DMMP	Ministria
Prill	Percjellja e zbatimit te rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave	Zbatimi sipas procedurave të parapara.	Pranimi i Raporteve me shkrim nga kompania e angazhuar per ecurine e punve ne rast te nevojës per plotesim /ndryshim te saj	DMMP	Komuniteti
	Dita Botërore e Tokës -22 prilli, Monitorim i mjedisit	Përzgjedhja e shkollave për pastrimin e qytetit	Pastrimi i qytetit dhe ngritja e vetëdijes	DMMP	DKA
	Monitorimi i ajrit	Kontrolli i sistemeve monitoruese	Marrja e rezultateve dhe vlerësimi i tyre	DMMP	MMPH
	Monitorimi i menaxhimit të mbeturinave në Gërmovë	Monitorimi i gjendjes së deponisë së mbeturinave	Vizita në teren dhe vlerësimi i gjendjes	DMMP	NP“UNITE TI”
Maj	Shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara - Qytet (mbëltimi i drunjve dhe luleve njëvjeçare)	Vlerësimi i gjendjes dhe përpilimi i projektit	Përmirësimi projekteve sipas specifikave teknike të parapara	DSHPI	

Qershor	Aktivitetet në bashkëpunim me OJQ lokale rreth mbrojtjes së cilësisë së Ajrit nga Ndotja	Takime pune	Nxjerrja e rekomandimeve të përbashkëta	DMMP	OJQ
	Monitorimi i deponisë së mbeturinave në Gërmovë	Monitorimi i gjendjes së deponisë së mbeturinave	Vizita në teren dhe vlerësimi i gjendjes	DMMP	NP "UNITETI"
	Monitorimi i cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës	Kontrolli i sistemeve monitoruese	Marrja e rezultateve dhe vlerësimi i tyre	DMMP	MMPH
	Vendosja e disa shportave për ndarje të mbeturinave në burim në Tunel të pare dhe ne Qytet te dedikuara per shishe te plastikes e gjera te tjera te plastikes	Kontrolli i sistemeve monitoruese	Marrja e rezultateve dhe vlerësimi i tyre	DMMP	
	Blerja e pasijeve për monitorimin e cilësisë së Ajrit në qytet	Bashkëaplikim me OJQ të ndryshme në fonde për tu pajisur me këto paisje	Marrja e rezultateve dhe vlerësimi i tyre	DMMP	OJQ
	Rregullimi i PGM-ve në disa rrugë të qytetit	Procedimi duke ndjekur procedurat e prokurimit	Marrja e rezultateve dhe vlerësimi i tyre	DMMP	
	Aktivitetet në bashkëpunim me OJQ lokale rreth mbrojtjes së cilësisë së Ajrit nga Ndotja	Takime pune	Nxjerrja e rekomandimeve të përbashkëta	DMMP	OJQ
	Hartimi i raportit për 6 mujorin e vitit 2025	Vlerësimi punëve të realizuara	Përshkrim i aktiviteteve për gjashtëmujorin e parë	DMMP	
	Kontrollimi i gjendjes së sipërfaqeve të gjelbëruara	Vlerësimi i gjendjes ekzistuese	Aktivitetet të cilat duhet të ndërmarrën për përmasimin e gjendjes	DMMP	
	Monitorimi i gjendjes së lumenjve në qytet	Vlerësimi i gjendjes, hartimi i projektit dhe mbikëqyrja	Pastrimi, monitorimi, heqja e mbeturinave.	DMMP	NP "UNITETI"
Gusht	Monitorimi i implementimit të Plani operativ për mbeturinat	Vlerësimi i gjendjes, hartimi i projektit dhe mbikëqyrja	Pastrimi, monitorimi, heqja e mbeturinave.	DMMP	NP "UNITETI"


	Planifikimi i buxhetit për vitin 2025, të DMMP	Vlerësimi i nevojave buxhetore për vitin 2025	Planifikimi i shpenzimeve të parapara për vitin 2025	DMMP	Komunitet
Shtator	Zhvillimi i procedurave tenderuese për shitjen e masës drunore të konfiskuar	Organizimi sipas procedurave të parapara.	Nëse ka sasi të drunjve të konfiskuara	DMMP	DP
	Organizimi i fushatave për vetëdijesimin e qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit	Organizimi sipas procedurave të parapara.	Ngritja e vetëdijes për mbrojtje të mjedisit	DMMP	DKA (Shkollat)
	Monitorimi i deponim së mbeturinave në Gjermovë	Monitorimi i gjendjes së deponim së mbeturinave	Vizita në teren dhe vlerësimi i gjendjes	DMMP	NP "UNITET"
	Monitorimi i vazhdueshëm i masës drunore të konfiskuar ecila gjendet në depon komunale në Frasher	Propozimi sipas procedurave të parapara.	Monitorimi i rajoneve pyjore, zbatimi i masave ligjore.	DMMP	APK Policia e Kosovës
	Shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara- në Qytet	Vlerësimi i gjendjes dhe përpilimi i projektit	Përmirësimi projekteve sipas specifikave teknike të parapara	DSHPI	
	Vlerësimi i gjendjes së zhurmës në qytet	Vlerësimi i gjendjes, hartimi i raportit dhe mbikëqyrja	Vizita në teren dhe vlerësimi i gjendjes dhe procedimin Kuvend	DMMP	Kuvendi
Tetor	Zhvillimi i procedurave tenderuese për shitjen e masës drunore të konfiskuar	Organizimi sipas procedurave të parapara.	Pranimi i Raporteve me shkrim nga kompania e angazhuar për ecurinë e punëve	DMMP	DP
	Aktivitetet në bashkëpunim me OJQ lokale rreth mbrojtjes së cilësisë së Ajrit nga Ndotja	Takime pune	Nxjerrja e rekomandimeve të përbashkëta	DMMP	OJQ
	Monitorimi i sipërfaqeve të gjelbëruara në qytet	Vlerësimi i gjendjes	Vlerësimi hapësirave publike të gjelbëruara	DMMP	
Nëntor					

Dhjetor	Raporti i gjendjes së mjedisit 2025	Vlerësimi i gjendjes	Procedimi në Kuvend	DMMP	Kuvendi
	Organizimi i fushatave për vetëdijesimin e qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit Transferimi i sistemit të mbeturinave në komuna ,	Organizimi sipas procedurave të parapara.	Ngritja e vetëdijes për mbrojtje të mjedisit	DMMP	DKA (Shkollat)
	Aktivitetet në bashkëpunim me OJQ lokale rreth mbrojtjes së cilësisë së Mjedisit nga Ndotja	Takime pune	Nxjerrja e rekomandimeve të përbashkëta	DMMP	OJQ
	Vlerësimi i gjendjes në mjedis : Transferimi i sistemit të mbeturinave në komuna, Ajër, Ujë, Tokë etj.	Monitorimi i gjendjes dhe vlerësimi	Vlerësimi i gjendjes ekzistuese	DMMP	Ministria
	Raporti vjetor 2025	Monitorimi i gjendjes dhe vlerësimi	Vlerësimi i gjendjes ekzistuese	DMMP	
	Plani i punës 2025	Planifikimi gjendjes	Planifikimi i objektivave të parapara	DMMP	

Të gjitha këto aktivitete të cekura më lartë do të jenë të detalizuara në raporte javore dhe kanë për qëllim që aksionet e zhvilluara të shëndrrohen në procese permanente me projekte multidisiplinare që Mitrovica qyteti ynë të jetë më i bukur, më i pastër dhe më i gjelbëruar, një nxitje të zhvillimit të qëndrueshëm.

Dhjetor - 2025

Drejtori i DMMP:



Egzon Sadiku

